




# ▶ UDHËZUES PËR SHFRYTËZIM TË NDIHMËS JURIDIKE FALAS








# UDHËZUES PËR SHFRYTËZIM TË NDIHMËS JURIDIKE FALAS



Shkurt, 2020  
Qendra për Demokraci Ekologjike FLOROZON  
Projekti: QASJE E BARABARTË PËR DREJTËSI EFEKTIVE



Publikimi:UDHËZUES PËR SHFRYTËZIM TË NDIHMËS JURIDIKE FALAS

Projekti: Qasje e barabartë për drejtësi efektive

Projekti është financuar nga Bashkimi Evropian përmes skemës së granteve

"Forcimi i ndikimit të shoqërisë civile për reforma efektive gjyqësore"

Autorë:

Natasha Amdiju

Kristina Najdovska Ilievski

Natasha Dokovska Spirovska

Miratuar nga:

Kryetari i Qendrës për Demokraci Ekologjike FLOROZON

Kiril Ristovski

Shkup, 2020

Ky publikim është përgatitur me mbështetje nga Bashkimi Evropian. Përmbajtja, qëndrimet dhe mendimet janë përgjegjësi vetëm e autorëve dhe në asnjë mënyrë nuk e reflektojnë qëndrimin e Bashkimit Evropian.




## PËRMBAJTJA

PARATHËNIE .....	5
1. LEGJISLACIONI NACIONAL .....	6
2. MEKANIZMA PËR QASJE NË DREJTËSI NË PËRPUTHJE ME LEGJISLACIONIN NACIONAL .....	6
2.1 Praktika jashtëgjyqësore në R. Maqedonisë së Veriut në fushën e mbrojtjes së mjedisit jetësor dhe qasja në drejtësi .....	6
2.2 Kostot e procedurës .....	7
3. KUSH MUND TË SHFRYTËZOJË NDIHMË JURIDIKE FALAS? .....	12
4. KUSH SIGURON NDIHMË JURIDIKE FALAS? .....	15
4.1 Lloje të ndihmës juridike falas .....	17
5. PROCEDURA PASI TË KËRKOHET NDIHMA PRIMARE DHE SEKONDARE JURIDIKE .....	19
5.1 Procedura pasi të kërkohet ndihma primare .....	19
6. PROCEDURA PASI TË KËRKOHET NDIHMA SEKONDARE JURIDIKE ....	20
7. OBLIGIMET E PJESËMARRËSVE NË PROCEDURËN PËR NDIHMË SEKONDARE JURIDIKE .....	22
8. SHTOJCA .....	24
Shtojca 1: Regjistri i shoqatave të autorizuara për të siguruar ndihmë primare juridike .....	24
Shtojca 2: Regjistri i fakulteteve juridike të autorizuara për të dhënë ndihmëprimare juridike .....	24
Shtojca 3: Kushtet minimale hapësinore dhe teknike që duhet t'i plotësojnë shoqatat për regjistrim në regjistrin e shoqatave të autorizuara për të siguruar ndihmë primare juridike .....	25
Shtojca 4: Aplikacioni për projekt për të siguruar ndihma primare juridike .....	26
Shtojca 5: Lista e shpenzime për vëllimin e punës së kryer na shoqatat dhe klinikat ligjore .....	30
Shtojca 6: Kërkesë për ndihmë sekondare juridike .....	32
Shtojca 7: Formë regjistrimi për ndihmë sekondare juridike .....	39
Shtojca 8: Raport për ndihmë sekondare juridike.....	40





Shtojca 9: Kërkesë për regjistrim në regjistër të avokatët e ndihmës sekondare juridike .....	41
Shtojca 10: Lista e shpenzime për ndihmën e dhënë sekondare juridike nga avokati.....	43
Shtojca 11: Lista e shpenzime për ndihmën e dhënë juridike nga avokati për fëmijë.....	44
Shtojca 12: Lista e shpenzime për ndihmën e dhënë sekondare juridike në procedurë për njohje të drejtës për azil .....	45
Shtojca 13: Kërkesë për ndihmë juridike falas në procedurë për njohjen e së drejtës së azilit .....	46
Shtojca 14: Kërkesë për regjistrim në regjistrin e shoqatat e krijuara për të ofruar ndihmë juridike parësore .....	49
Shtojca 15: Kërkesë për regjistrim në regjistrin e fakulteteve juridike të autorizuara për të ofruar ndihmë primare juridike .....	52
Shtojca 16: Evidenca e të dhënave në lidhje me ndihmën primare juridike .....	53
Shtojca 17: Evidenca e shpenzimeve për dhënie të ndihmës sekondare juridike nga avokati .....	54
Literatura e shfrytëzuar .....	55



## PARATHËNIE

*Ky udhëzues është pjesë e projektit "Qasje e barabartë për drejtësi efektive", që implementohet nga Shoqata Civile Qendra për Demokraci Ekologjike Florozon. Projekti është i financuar nga Bashkimi Evropian përmes Skemës së Grantëve CFSD në Ministrinë e financave - "Forcimi i Ndikimit të Shoqërisë Civile mbi Reformat efektive në sektorin e drejtësisë" EuropeAid/159467/ID/ACT/MK, Numri i kontratës 12-6208/1.*

*Qëllimi i projektit është të kontribuojë në krijimin e një gjyqësori të pavarur, të paanshëm, efikas, cilësor dhe transparent, përgjegjës për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive individuale të qytetarëve, me çka do të mundësohet mbrojtje adekuatë e interesit publik. Objektivat specifike e përfshijnë kontributin në ndërtimin e një sistemi efektiv të ndihmës juridike, rritjen e kapaciteteve ekzistuese të OShC-ve dhe përfaqësuesve të institucioneve relevante të ligjit për mjedis jetësor dhe mundësive për ndihmë juridike falas, sigurim të ambientit për grupet e marginalizuara dhe rritjen e ndërgjegjësimit të publikut për të drejtën për mjedis jetësor dhe mekanizmat ekzistues juridikë.*

*Ky udhëzues duhet t'u shërbejë qytetarëve që ata përmes Ligjit për ndihmë juridike falas të realizojnë të drejtat e tyre të garantuara kushtetuese për mjedis të shëndosh jetësor.*

*Përdoruesit e fundit janë organizatat civile, qytetarët, grupet e lëndueshme dhe të marginalizuara në shoqëri.*





## 1. LEGJISLACIONI NACIONAL

E drejta për mjedis të shëndosh garantohet me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë e Veriut, me aktet ligjore dhe nënligjore, si dhe me konventat e ratifikuara.

Çështjet e veçanta mjedisore rregullohen në ligje dhe akte nënligjore të veçanta, si dhe dispozita ligjore për mbrojtjen e mjedisit.

Përveç rregulloreve dhe politikave të përgjithshme, objektet që shkaktojnë ndikime në mjedis janë përcaktuara edhe me akte të veçanta ligjore që më ngushtë e rregullojnë ndonjë veprimtari të caktuar ekonomike.

Ligji për Ndhimën Juridike Falas (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë e Veriut Nr. 101/2019) e specifikon mundësinë e ndihmës juridike falas, si dhe procedurat dhe personat të cilët o plotësojnë kushtet për shfrytëzuar të drejtën për ndihmë juridike falas. Vetë ligji nuk përcakton në mënyrë të qartë të drejtën e shfrytëzimit të ndihmës juridike falas në fushën e mjedisit, por mundësia për të marrë këtë lloj ndihme nuk është e përjashtuar.

Varësisht nga lloji shkeljes së të drejtës në fushën e mjedisit jetësor, mbrojtje ligjore mund të kërkohej në disa lloje procedurash, edhe atë procedura civile, administrative, kushtetuese. E drejta për ndihmë juridike falas në fushën e procedurave penale rregullohet në mënyrë të qartë me Ligjin për procedurë penale. Mundësia për ndihmë juridike falas, përkatësisht për ulje të shumës së tarifave në pjesën e qasjes në drejtësi në fushën e mjedisit mund të arrihet duke iu referuar Konventës së ratifikuar të Arhusit.

## 2. MEKANIZMA PËR QASJE NË DREJTËSI NË PAJTIM ME LEGJISLACIONIN NACIONAL

### 2.1 Praktikë jashtëgjyqësore dhe gjyqësore në R. e Maqedonisë së Veriut në fushën e mjedisit jetësor dhe qasja në drejtësi

Në pajtim me legjislacionin nacional, mekanizmat që mund të shfrytëzohen për të drejtën për qasje në drejtësi nga fusha e mjedisit jetësor, janë rregulluar dhe mundësuar në procedura jashtëgjyqësore dhe procedura gjyqësore.

Procedura jashtëgjyqësore mund të iniciohen pranë Avokatit të popullit dhe trupa të tjerë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.


Ndihmë dhe intervenim nga Avokati i Popullit mund të kërkojë çdo qytetar dhe shtetas i huaj (personalisht ose nëpërmjet personit të autorizuar nga ai) kur do të vlerëson që është shkelur ndonjë e drejtë e tij kushtetuese dhe/ose ligjore me akte apo veprime të organeve të administratës shtetërore dhe organe tjera të cilat kanë autorizime publike.

Ndërmjetësimi është mënyrë alternative për zgjidhje të kontesteve në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Procedura e ndërmjetësimit është vullnetare, efikase, e shpejtë dhe më e lirë nga procedura gjyqësore. Kontestet nga fusha e mjedisit jetësor janë konteste që mund të ndërmjetësohen dhe si të tilla mund të realizojnë qasje në drejtësi nëpërmjet procesit të ndërmjetësimit.

Mekanizmi për realizim të qasjes në drejtësi është edhe konventa e Arhusit, instrument për mbrojtje të mjedisit jetësor, i cili mundëson që procedurat për mbrojtje të zbatohen me shpenzime të zvogëluara apo krejtësisht falas.

Mekanizëm për realizimin e të drejtës për mjedis jetësor të shëndetshëm janë edhe procedurat gjyqësore, përkatësisht procedura pranë Gjykatës Kushtetuese të RMV-së, procedura civile, procedura administrative, procedura për kundërvajtje dhe procedura penale.





### ■ **Procedurë pranë Gjykatës Kushtetuese të RMV-së**

Secili qytetarë i RMV-së mund të parashtrojë, pranë Gjykatës kushtetuese, iniciativë për ngritjetë procedurës përvlerësim të kushtetutshmërisë së ndonjë ligji apo kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë e ndonjë dispozite tjetër, si dhe kushtetutshmërinë e programeve dhe statuteve të partive politike dhe shoqatave të qytetarëve. Parashtrimi i iniciativave nuk ndërlidhet me ekzistim të interesit juridik të parashtruesit, vetëm nevojitet që iniciativa të parashtrohet në formë përkatëse, përkatësisht akti që kontestohet të përcaktohet saktë, njëlloj edhe shkaqet për të cilat kontestohet akti, cilat dispozita kushtetuese dhe ligjore shkelen me aktin e kontestuar dhe kush është i parashtruesi. Procedura për mbrojtje të lirive dhe të drejtave të njeriut, iniciohet me kërkesë (ankesë kushtetuese) nga secili person i cili konsideron që ndonjë nga liritë dhe të drejtat e përmendura i janë shkelur me akt përfundimtar apo akt të plotfuqishëm ose me veprim.

### ■ **Procedurë civile**

Për të iniciuar procedurë civile, duhet të vërtetohet legjitimacioni aktiv dhe paditësit duhet të jenë persona të cilët drejtpërsëdrejti i vuajnë pasojat e dëmshme nga burimi i rrezikut. Gjatë procedurës civile, organizatat qytetarët mund të paraqiten si ndërhyrës.

### ■ **Procedurë administrative**

Procedura administrative iniciohet me kërkesë të një pale apo nga ndonjë organ publik me detyrë zyrtare. Procedurën administrative e inicion organ kompetent me detyrë zyrtare ose me kërkesë të parashtruar nga pala. Procedura për ngritje të kontestit administrativ është e rregulluar me Ligjin për konteste administrative. Punë administrative janë të gjitha aktet dhe veprimet nëpërmjet të cilave shprehen dhe ushtrohen kompetencat e administratës publike. Si akte administrative konsiderohen të gjitha ato akte dhe veprime me të cilat vendoset për të drejtat, obligimet ose interesat juridike të palëve në procedurën administrative. Procedura administrative është e rregulluar me Ligjin për procedurë të përgjithshme administrative. Sipas dispozitave të këtij ligji fushë e veprimit janë të gjitha çështjet administrative që nuk janë rregulluar me ligj të veçantë.

### ■ **Procedurë për kundërvajtje**

Procedurë për kundërvajtje iniciohet për ndotësit si dënime mandatore apo kallëzime për kundërvajtje.


## 2.2 Shpenzime për procedurën

### ■ **Shpenzime në procedurë kontestimore**

Në pajtim me nenin 145 të Ligjit për procedurë kontestimore – Shpenzimet kontestimore i përbëjnë harxhimet që janë bërë gjatë ose për shkak të procedurës. Shpenzimet kontestimore e përfshijnë edhe shpërblimin për avokatin dhe personat tjerë të cilëve ligji u përcakton të drejtë për shpërblim.

Çdo palë paraprakisht i parashtron shpenzimet që i ka bërë me veprimin e vet. Gjykata nuk do të veprojë në bazë të ndonjë padie, as nuk do të ndërmerr ndonjë veprim për të cilin nuk është paguar taksa gjyqësore. Nëse paditësi nuk e paguan taksën gjyqësore në afat prej 15 ditësh nga dita e parashtrimit të padisë, vlerësohet që padia është tërhequr. Kur pala do të propozojë prezantim të provave, është e obliguar në bazë të urdhrit të gjyqit paraprakisht ta deponojë shumën e duhur për të mbuluar shpenzimet që do të rezultojnë nga prezantimi i provave. Kur dyja palët do të propozojnë prezantim të provave apo kur gjykata do ta përcaktojë atë, gjykata është ajo që e përcakton edhe shumën e nevojshme për të mbuluar shpenzimet të cilat dy palët duhet ta deponojnë në pjesë të barabarta. Pala e cila do ta





humb kontestin tërësisht, është e detyruar t'ia kompensojë shpenzimet palës tjetër dhe ndërmjetësuesit të saj. Nëse një palë e fiton pjesërisht kontestin, gjykata, duke pasur parasysh nivelin e fitores, mund të përcaktojë që secila palë t'i mbulojë (bartë) shpenzimet e veta ose njëra palë të kompensojë pjesën proporcionale të shpenzimeve të palës tjetër dhe ndërmjetësuesit. Gjykata mund të vendos që njëra palë t'ia kompensojë të gjitha shpenzimet që pala tjetër dhe ndërmjetësuesi i saj i kanë pasur, nëse pala tjetër nuk ia ka dalë të fitojë ndonjë pjesë proporcionalisht të vogël të kërkesës së vet, kurse për shkak të asaj pjese nuk janë shfaqur shpenzime të posaçme. Gjykata, duke i vlerësuar me vëmendje të gjitha rrethanat, merr vendim cilat shpenzime kanë qenë të domosdoshme, si dhe për lartësinë e të njëjtave. Shpërblimi dhe shpenzimet tjera për avokatët përlllogariten sipas tarifës për kompensim të shpenzimeve të avokatëve. Pavarësisht përfundimit të kontestit, pala është e detyruar që palës tjetër t'ia kompensojë shpenzimet që i ka shkaktuar. Paditësi i cili do ta tërheq padinë është i detyruar që palës tjetër t'ia kompensojë shpenzimet kontestimore, përveç nëse tërheqja e padisë ka ndodhur menjëherë pas plotësimit të kërkesës nga ana e të paditurit. Kur të përfundojë procedura, secila palë me barazim gjyqësor i parashtron shpenzimet e veta, përveç nëse në barazimin gjyqësor nuk ka marrëveshje ndryshe. Shpenzimet barazim, për të cilat është bërë përpjekje të realizohen, por realizimi nuk ka qenë i suksesshëm, përfshihen në shpenzimet kontestimore. Kur prokurori publike paraqitet si palë në procedurë ai ka të drejtë për kompensim të shpenzimeve sipas dispozitave të Ligjit për procedurë kontestimore. Shpenzimet që duhet t'i parashtrorë prokurori publik paguhen nga Buxheti i R. së Maqedonisë së Veriut. Pala është e detyruar ta thekson kërkesën për kompensim të shpenzimeve, më së voni deri në përfundim seancës, e cila i paraprin vendimit për shpenzimet. Nëse bëhet fjalë për miratim të vendimit pa debat paraprak, pala është e obliguar që kërkesën për kompensim të shpenzimeve ta paraqet në propozimin, për të cilën gjyqi pastaj duhet të vendos në aktgjykimin apo vendimin me të cilin përfundohet procedura pranë atij gjyqi. Gjatë publikimit të aktgjykimit apo vendimit në mënyrë verbale me të cilin kërkohet kompensim i shpenzimeve, gjykata mund të vendosë që shumën e shpenzimeve ta përlllogarit në aktgjykim, përkatësisht vendim të përpiluar me shkrim, nëse vendimi duhet t'u dërgohet palëve.


#### ■ **Shpenzime të procedurës për sigurim të provave**

Shpenzimet e procedurës për sigurim të provave i parashtron pala e cila ka parashtruar propozim për sigurim të provave. Ajo është e detyruar t'ia kompensojë shpenzimet palës tjetër, përkatësisht përfaqësuesit të përcaktuar të përkohshëm. Këto shpenzime pala mund t'i realizojë në mënyrë plotësuese si pjesë e shpenzimeve kontestimore, varësisht nga suksesi në procedurë.

#### ■ **Lirim nga pagesa e shpenzimeve të procedurës**

Sipas nenit 163 të Ligjit për procedurë kontestimore, gjykata do ta lirojë palën, nga pagesa e shpenzimeve të procedurës, e cila sipas gjendjes së përgjithshme pronësore nuk ka mundësi t'i mbulon këto shpenzime pa e dëmtuar mbajtjen e vet të domosdoshme dhe mirëmbajtjen e familjes së vet. Lirimi nga pagesa e shpenzimeve të procedurës përfshin lirim nga pagesa e taksave dhe lirim nga deponimi i parapagesës (avansit) për shpenzimet e dëshmitarëve, ekspertëve, për inspektim dhe për shpalljet gjyqësore. Gjykata mund ta liron palën vetëm nga pagesa e taksave, nëse me pagesën e taksave konsiderueshëm do të zvogëlohen mjetet nga të cilat ekziston pala dhe anëtarët e familjes së palës.

Gjatë miratimit të vendimit për lirim nga pagesa e shpenzimeve për procedurë, gjykata do t'i vlerësojë të gjitha rrethanat, duke e marrë parasysh vlerën e lëndës së kontestit, numrin e personave të cilët u mirëmban pala dhe të ardhurat e palës dhe anëtarëve të familjes së saj. Gjykata e shkallës së parë, me propozim të palës, e sjell vendimin për lirim nga



pagesa e shpenzimeve të procedurës. Pala është e detyruar që propozimit t'i bashkëngjit vërtetim për gjendjen e saj pronësore, të lëshuar nga organi kompetent i administratës shtetërore. Në vërtetimin për gjendjen pronësore duhet të shënohet shuma e tatimit që e paguan amvisërisë së palës dhe anëtarë të veçantë të asaj amvisërie, të ardhura të tjera dhe gjendja pronësore e palës në përgjithësi. Gjykata me detyrë zyrtare mund t'i sigurojë të dhënat e nevojshme dhe njoftimet për gjendjen pronësore të palës e cila kërkon lirim, kurse për çështjen e njëjtë mund ta dëgjojë edhe palën tjetër.

Kundër vendimit të gjykatës me të cilin miratohet propozimi i palës nuk lejohet ankesë. Kur pala është tërësisht e liruar nga pagesa e shpenzimeve të procedurës, gjykata e shkallës së parë me kërkesë të saj do të përcaktojë përfaqësues të autorizuar për ta, nëse kjo është e nevojshme për mbrojtjen e të drejtave të palës. Pala të cilës i është përcaktuar përfaqësues lirohet nga pagesa e shpenzimeve dhe nga shpërblimi për përfaqësuesin e autorizuar. Përfaqësuesin e autorizuar nga radhët e avokatëve e përcakton kryetari i gjyqit.

#### ■ Shpenzime në procedurë penale

Në pajtim me nenin 102 të Ligjit për procedurë penale, shpenzimet për procedurë penale janë harxhimet që janë bërë për procedurën penale, nga fillimi E deri në përfundim dhe harxhimet për veprime hetuese që janë ndërmarrë para procedurës hetimore. Shpenzimet e procedurës penale përfshijnë:

1. Shpenzime për dëshmitarë, ekspertë, përkthyes, interpretues dhe profesionistë, shpenzimet për incizimet audio-vizuele dhe transkriptim i incizime, si dhe shpenzime për inspektim;
2. Shpenzime për transport të të akuzuarit;
3. Harxhime për ndalim të të akuzuarit, përkatësisht personit të privuar nga liria;
4. Shpenzime për transport dhe rrugore të personave zyrtarë;
5. Shpenzime për mjekim të të akuzuarit gjatë kohës që gjendet në paraburgim, si dhe shpenzime për lindje, përveç shpenzimeve që arkëtohen nga fondi për sigurim shëndetësor;
6. Shumë paushall;
7. Shpërblim dhe harxhime të duhura të mbrojtësit, harxhime të domosdoshme të paditësit privat dhe përfaqësuesit të tij ligjor, si dhe shpërblim dhe harxhime të duhura të përfaqësuesit të vet dhe
8. Harxhime të duhura të palës së dëmtuar dhe të përfaqësuesit të vet ligjor, si dhe shpërblim dhe harxhime të duhura të përfaqësuesit të vet.


#### ■ Vendim për shpenzimet të procedurës penale

Në çdo aktgjykim dhe vendim me të cilin ndërpritet procedura penale vendoset kush do t'i mbulon shpenzimet e procedurës dhe shumën e të njëjtave.

#### ■ Parashtrim i shpenzimeve që janë bërë me faj personal

I akuzuari, i dëmtuari, paditësi privat, përfaqësuesi ligjor, i autorizuari, dëshmitari, eksperti, përkthyesi, interpretuesi dhe personi profesional, pavarësisht rezultatin përfundimtar të procedurës penale, i parashtron shpenzimet për angazhimin e tyre, për shtyrjen e debatit kryesor dhe shpenzimet tjera të procedurës që i kanë shkaktuar me faj të tyre. Për shpenzimet miratohet vendim i posaçëm, përveç nëse për shpenzimet që i parashtron paditësi privat dhe i akuzuari vendoset në vendimin për lëndën kryesore.





### ■ **Vendimmarrje për shpenzimet në aktgjykim gjykues**

Kur gjyqi e shpall personin e pandehur fajtor, në aktgjykim do të theksohet që ai detyrohet t'i kompensojë shpenzimet e procedurës penale. Personi i cili është i akuzuar për më tepër vepra penale nuk do të gjykohet t'i kompensojë shpenzimet lidhur me veprat për të cilat është i liruar nga akuza, nëse ato mund të veçohen nga shpenzimet e përgjithshme. Në aktgjykimin me të cilin më tepër të akuzuar janë shpallur fajtor, gjykata do të përcakton pjesën e shpenzimeve që do ta bartë secili prej tyre, e nëse kjo nuk është e mundur, atëherë gjykata me vendim që të gjithë të akuzuarit t'i mbulojnë shpenzimet në mënyrë solidare. Pagesa e shumës paushall do të përcaktohet për secilin të akuzuar veçmas.

Në vendimin me të cilin vendoset për shpenzimet, gjykata mund ta lirojë të akuzuarin nga obligimi për t'i kompensuar tërësisht apo pjesërisht shpenzimet e procedurës penale, nëse me pagimin e tyre është vënë në pikëpyetje ekzistenca e të akuzuarit ose e personave për të cilët ai është i obliguar të siguron ekzistencë. Nëse konstatohen këto rrethana pas miratimit të vendimit për shpenzimet, kryetari i këshillit, me vendim të posaçëm mund ta lirojë të akuzuarin nga obligimi për kompensim të shpenzimeve për procedurën penale.

### ■ **Shpenzime të mbrojtësit dhe të autorizuarit**


Personi i përfaqësuar është i obliguar t'ia paguan shpërblimin dhe shpenzimet e domosdoshme mbrojtësit dhe personit të autorizuar të paditësit privat apo personit të dëmtuar, pa marrë parasysh atë, që sipas vendimit të gjykatës është i obliguar t'i mbulon shpenzimet e procedurës penale, përveç nëse sipas dispozitave të LPP-së, shpërblimi dhe harxhimet e domosdoshme të mbrojtësit i mbulon Buxheti i R. së Maqedonisë së Veriut. Nëse për të akuzuarin është përcaktuar mbrojtës, kurse me pagesën e shpërblimit dhe të harxhimeve të domosdoshme i është vënë në pikëpyetje ekzistenca ose ekzistenca e personit për të cilin ai është i obliguar të kujdeset shpërblimin dhe harxhimet e domosdoshme për avokatin do të paguhet nga Buxheti i R. së Maqedonisë së Veriut. Personi i autorizuar i cili nuk është avokat nuk ka të drejtë për shpërblim, përveç për kompensim të harxhimeve të domosdoshme.

Shumën dhe mënyrën e shpenzimeve që janë bërë realisht në procedurën penale i përcakton kryetari i Gjykatës Supreme pasi paraprakisht të pranohet mendim nga prokurori publik i R. së Maqedonisë së Veriut.

### ■ **Shpenzime të procedurës së përgjithshme administrative/Shpenzime të organit dhe të palëve:**

Harxhimet e veçanta monetare kesh të organit që e zbaton procedurën, siç janë: shpenzimet rrugore të personave zyrtarë, harxhimet për dëshmitarë, ekspertë, interpretues, inspektime, shpallje dhe ngjashëm, e të cilat kanë ndodhur me zbatim të procedurës pas ndonjë pune administrative, sipas rregullit i mbulon ai që e ka shkaktuar procedurën. Kur personi i cili merr pjesë në procedurë me faj të vet ose për shkak të sjelljes joadekuate shkaktonte shpenzim për vepra të caktuara në procedurë, është i detyruar t'i mbulon ato shpenzime.

Kur procedura që është nisur me detyrë zyrtare ka përfunduar në favor të palës, shpenzimet e procedurës i mbulon organi i cili e ka iniciuar procedurën. Secila palë, sipas rregullit, vet i mbulon shpenzimet e saj të shkaktuara me procedurën, siç janë shpenzimet për ardhje, koha e humbur, harxhimet për taksë, për përfaqësim juridik, ndihmë profesionale dhe tjera. Kur në procedurë marrin pjesë dy ose më tepër palë me interesa të kundërta, pala e cila e ka shkaktuar procedurën, e në dëm të cilës ka përfunduar procedura, është e obliguar t'ia kompensojë shpenzimet e arsyeshme që i kanë ndodhur palës tjetër me pjesëmarrjen në procedurën.



Kur ndonjë prej palëve pjesërisht ia ka dalë të realizojë kërkesën e vet, ajo e ka për obligim që palës tjetër t'ia kompensojë shpenzimet proporcionalisht me pjesën e kërkesës së vet për të cilën nuk ka pas sukses. Pala e cila me sjellje të papërshtatshme i ka shkaktuar palës tjetër harxhime në procedurë, është e detyruar t'ia kompensojë ato shpenzime. Shpenzimet për përfaqësim juridik kompensohen vetëm në rastet kur përfaqësimi i tillë ka qenë i domosdoshëm dhe i arsyeshëm.

Kërkesa për kompensim të këtyre shpenzimeve duhet të parashtrohet me kohë, që organi i cili e zbaton procedurën të mund të vendos për atë në vendimin përfundimtar. Në të kundërtën, pala do të humb të drejtën për kompensim të shpenzimeve. Personi zyrtar i cili e zbaton procedurën është i obliguar që ta paralajmërojë palën për këtë. Secila palë i mbulon shpenzimet e veta të procedurës që është përfunduar me barazim, nëse në barazimin e shpenzimeve nuk është përcaktuar ndryshe. Shpenzimet e palës apo ndonjë personi tjetër në procedurë të shkaktuara me procedurën e iniciuar me detyrë zyrtare është në interes publik, të cilat pala, përkatësisht person tjetër në procedurën nuk i ka shkaktuar me sjelljen e vet, i mbulon organi i cili e ka iniciuar procedurën.

Nëse procedura iniciohet me kërkesë të palës, ndërsa me siguri mund të parashihet që do të shkaktojë harxhime të posaçme monetare kesh lidhur me inspektimin, ekspertizën, ardhjen e dëshmitarëve dhe ngjashëm, organi që e zbaton procedurën, me konkluzion mund paraprakisht ta përcaktojë palën për të deponuar shumën e nevojshme për të mbuluar ato shpenzime. Nëse pala nuk e deponon atë shumë në afatin e përcaktuar, organi mund të heq dorë nga prezantimi i atyre provave ose ta ndërpresë procedurën, përveç nëse interesi publik kërkon që procedura të vazhdohet. Në vendimin me të cilin ndërpritet procedura, organi i cili e sjell vendimin përcakton kush i mbulon shpenzimet e procedurës, shumën e tyre, kujt dhe në çfarë afati duhet t'i paguhen. Në aktvendimin doemos duhet veçmas të theksohet nëse ai që i mbulon shpenzimet duhet edhe t'i kompensojë shpenzimet e palës tjetër.

Nëse shpenzimet e procedurës i mbulojnë më shumë persona, shpenzimet do të ndahen ndërmjet tyre në pjesë të barabarta, përkatësisht në proporcion të përshtatshëm. Nëse organi nuk vendos për shpenzimet në vendim, atëher po në atë vendim do të thekson që për shpenzimet do të miratojë konkluzion të posaçëm.

Dëshmitarët, ekspertët, interpretuesit dhe personat zyrtarë kanë të drejtë për kompensim të shpenzimeve për udhëtim, të harxhimeve që janë shkaktuar me qëndrimin në ndonjë vend, ndërsa nëse për atë kohë nuk u takojnë të ardhura, kanë të drejtë edhe për kompensim të ardhurat e humbura. Krahas kompensimit, ekspertët dhe interpretuesit kanë të drejtë edhe për shpërblim të posaçëm. Kërkesën për kompensim përkatësisht për shpërblim, dëshmitarët, ekspertët dhe interpretuesit janë të detyruar ta parashtrorjnë gjatë dëgjimit, interpretimit, përkatësisht dhënies së mendimit të ekspertit. Në të kundërtën e humbin atë të drejtë, kurse personi zyrtar i cili e zbaton procedurën është i obliguar për këtë ta paralajmëron dëshmitarin, ekspertin dhe interpretuesin. Shumën e kompensimit e përcakton me konkluzion të veçantë organi që e zbaton procedurën, duke përcaktuar kush e ka detyrimin për ta paguar kompensimin dhe brenda cilit afat. Kundër këtij konkluzioni lejohet ankesë e veçantë. Ky konkluzion paraqet bazë për përmbarim.

#### ■ Lirim nga pagesa e shpenzimeve

Në pajtim me nenin 123 e Ligjit për procedurën të përgjithshme administrative, organi që e zbaton procedurën mund ta lirojë palën nga mbulimi i shpenzimeve në tërësi apo pjesërisht, nëse konstaton që pala nuk ka mundësi t'i mbulon shpenzimet pa e dëmtuar ekzistencën e vet të domosdoshme dhe për të mirëmbajtur të familjes vet. Organi sjell konkluzion për atë sipas propozimit të palës në bazë të vërtetimit për gjendjen pronësore





të palës që është lëshuar nga organi kompetent.

Lirimi nga mbulimi i shpenzimeve ka të bëjë me lirim nga taksat, nga harxhimet e organit që e zbaton procedurën, siç janë shpenzimet rrugore të personave zyrtarë, harxhime për dëshmitarë, ekspertë, interpretues, inspektim dhe shpallje, si dhe lirim nga deponimi për shpenzimet.

Shtetasit e huaj do të lirohen nga mbulimi i shpenzimeve vetëm me kusht të reciprocitetit. Në rast të dyshimit për ekzistim të reciprocitetit, sqarim jep organi i administratës shtetërore kompetent për punë të jashtme. Organi që e zbaton procedurën mund të anulon konkluzionin, gjatë procedurës, për lirim të mbulimit të shpenzimeve nëse konstaton se më nuk ekzistojnë shkaqe për të cilat pala ka qenë e liruar nga mbulimi i shpenzimeve. Kundër konkluzionit me të cilin refuzohet kërkesa e palës për lirim nga mbulimi i shpenzimeve, pala mund të parashtrorë ankesë të veçantë.

### 3. KUSH MUND TË SHFRYTËZOJË NDIHMË JURIDIKE?

Varësisht nga lloji i ndihmës juridike falas që mund të kërkohet, ekzistojnë edhe kritere të ndryshme që janë rregulluar në Ligjin për ndihmë juridike falas të cilat personat – kërkues të ndihmës falas duhet t'i plotësojnë. Ndhimë primare juridike mund të kërkojë çdo person, ndërsa ndihmë sekondare juridike mund të shfrytëzojnë vetëm persona të cilët plotësojnë kushte të caktuara.


Ndhimë primare juridike i jepet secilit person të interesuar. Takimi i parë në Ministrinë për Drejtësi, në shoqatën e autorizuar ose në klinikën juridike është me qëllim që personit të interesuar t'i sqarohet natyra e problemit ose të përcaktohet nëse problemi është çështje juridike, nëse i njëjti është në kuadër të gamës së shërbimeve juridike të cilat Ministria e drejtësisë, shoqata dhe klinika juridike i japin, si dhe llojet e ndihmës juridike të cilat janë më të përshtatshmet për atë person. Ministria e drejtësisë, shoqata dhe klinika juridike nuk kanë të drejtë të veprojnë në emër dhe në llogari të personit, gjatë procedurës për ndihmë primare juridike.

Ndhimë sekondare juridike miratohet për person kërkesa e të cilit është e arsyeshme, i cili ka nevojë për ndihmë profesionale juridike nga avokat për punë konkrete juridike dhe i cili nuk ka mundësi t'i paguan shpenzimet e procedurës për shkak të gjendjes së tij financiare. Ndhimë sekondare juridike përfshin përfaqësim në procedurë pranë gjykatës, organit shtetëror, Fondit për sigurim pensional dhe invalidor në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Fondit për sigurim shëndetësor në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe personave të cilët ushtrojnë autorizime publike. Kjo nënkupton përfaqësim pranë të gjitha niveleve në procedurë civile, administrative dhe konteste administrative, përfaqësim pranë noterit në procedurë për diskutim për trashëgiminë, përpilim të parashtresave të debitorit pranë përmbaruesit kompetent, kur përmbarimi zbatohet me shitje të patundshmërive, si dhe lirim të shpenzimeve në pajtim me dispozitat e parapara në Ligjin për ndihmë juridike falas ose në ndonjë ligj tjetër.

#### ■ Të drejtë për të parashtruar kërkesë për ndihmë sekondare juridike ka:

Person shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut me vendbanim permanent në Republikën e Maqedonisë së Veriut;

Shtetas i huaj me leje për qëndrim të përkohshëm ose të përhershëm në Republikën e Maqedonisë së Veriut ose person pa shtetësi i cili legalisht qëndron në Republikën e Maqedonisë së Veriut;



Person i cili ka të drejtë për ndihmë juridike të siguruar nga Republika e Maqedonisë së Veriut në pajtim me marrëveshjet e ratifikuara në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut; dhe

■ **Kërkues të drejtës për azil.**

Kërkuesi i ndihmës sekondare juridike ka të drejtë të shfrytëzon ndihmë sekondare juridike nëse për shkak të gjendjes së vet financiare nuk mund t'i realizojë të drejtat e garantuara me ligj dhe me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut, pa e rrezikuar ekzistencën personale dhe ekzistencën e anëtarëve të familjes së vet me të cilët jeton në amvisëri të përbashkët. Gjendja financiare e kërkuesit dhe e anëtarëve të familjes përcaktohet në bazë të deklaratës me shkrim për gjendjen financiare që e ka dhënë kërkuesi i ndihmës juridike, e cila është pjesë e kërkesës për ndihmë juridike falas.

■ **Kushte për të ardhura të kërkuesit**

Vlerësohet që gjendja financiare e kërkuesit dhe e anëtarëve të familjes tij është e rrezikuar me shpenzime e procedurës nëse:

Të ardhurat mujore të kërkuesit, i cili jeton vetëm, nuk e tejkalojnë shumën e neto pagës minimale në Republikën e Maqedonisë së Veriut, të përcaktuar me dispozitat nga fusha e pagës minimale;

Të ardhurat mujore të kërkuesit i cili jeton në amvisëri të përbashkët me anëtarët e familjes tij nuk e tejkalojnë shumën e neto pagës minimale dhe të ardhurat mujore të secilit anëtarë tjetër të familjes nuk e tejkalojnë shumën prej 20% të neto pagës minimale të përcaktuar me dispozitat nga fusha e pagës minimale.

■ **Të ardhura mujore të kërkuesit të ndihmës juridike dhe të anëtarëve të familjes së tij konsiderohen:**

1. Neto paga;
2. Pension që realizohet në Republikën e Maqedonisë së Veriut ose jashtë shtetit;
3. Kompensim monetare në bazë të papunësisë;
4. Neto të ardhura të realizuara ose të paraqitura në Drejtorinë e të Ardhurave Publike;
5. Të ardhura për mbështetje financiare nga fusha e bujqësisë dhe zhvillimit rural që janë realizuar vitin paraprak;
6. Pension invalidor nga lufta ose civil;
7. Të ardhura nga punë e përkohshme jashtë vendit;
8. Të ardhura të realizuara nga instrumentet financiare;
9. Të ardhura nga prona;
10. Mjete financiare të bartës të qarkullimit pagesor;
11. Alimentacion ligjor; dhe
12. 1Dhurata për të cilat obliguesit tatimor janë të obliguar të paguajnë tatim mbi të ardhura nga veprimtari në pajtim me dispozitat e Ligjit për tatim mbi të ardhura.

■ **Të ardhura nuk konsiderohen:**

1. Kompensim monetare për ndihmë dhe kujdes nga person tjetër;





2. Shtesë prindërore për fëmijë;
3. Shtesë feminare dhe shtesë e veçantë;
4. Kompensim për dëmtim trupor;
5. Ndihmë sociale monetare;
6. Ndihmë e përhershme monetare;
7. Ndihmë e njëfishtë monetare dhe ndihmë me materiale;
8. Kompensim monetar për shpenzime për person të akomoduar dhe kompensim për akomodim të personit në familje akomoduese;
9. Ndihmë e njëfishtë monetare për foshnje;
10. Alimentacion ligjor për fëmijë që harmonizohet ne rritjen e shpenzimeve për jetë për vitin e kaluar, të publikuara nga Enti Shtetëror për Statistikë, në janar për vitin rrjedhës;
11. Ndihmë monetare për banim social;
12. Kompensim për regjistruar për kryerje të punëve lidhur me zbatimin e regjistrimit të popullatës, ekonomive familjare dhe banesave në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe anëtarëve të familjeve;
13. Bursë;
14. Mjete të miratuara nga institucion kompetent për trajtim mjekësor jashtë shtetit;
15. Ndihmë për shurdhësi;
16. Ndihmë për verbëri dhe mobilitet;
17. Kompensim të pagës për orar të shkurtuar pune për shkak të kujdesit për fëmijë me pengesa trupore ose mentale në zhvillim; dhe
18. Ndihmë monetare për person i cili deri në moshën 18 vjeçe ka pasur status të fëmijës pa prind dhe pa kujdes prindëror.

■ **Kushte për pronën e kërkuarit**


Ndihmë juridike falas do t'i lejohet kërkuarit, nëse në bazë të deklaratës së parashtruar për gjendjen financiare të kërkuarit dhe anëtarëve të familjes së vet, konstatohet që:

1. Kërkuari i ndihmës juridike dhe anëtarët e familjes së vet në pronësi kanë vetëm një objekt njëbanesor ose banesë në pjesë të posaçme të ndërtesës në të cilën jetojnë;
2. Krahas pronës së përmendur në alinenë 1 e këtij paragrafi, kërkuari dhe anëtarët e familjes së vet në pronësi kanë një ose më shumë parcela fizike të lidhura kadastrale me sipërfaqe të përgjithshme jo më të madhe se 300 m<sup>2</sup> në Shkup; ose 500 m<sup>2</sup> në komunat në Republikën e Maqedonisë së Veriut, përkatësisht një ose më shumë parcela kadastrale me sipërfaqe të përgjithshme kadastrale jo më të madhe se 5000 m<sup>2</sup> në zona rurale; dhe
3. kërkuari i ndihmës juridike dhe anëtarët e familjes tij kanë vetëm një mjet të regjistruar motorik vëllimi i motorit të të cilit nuk është mbi 1 200 centimetër kub.

■ **Pronë nuk do të konsiderohen:**

1. Objekte të cilat në pajtim me Ligjin për përmbarim nuk i nënshtrohen përmbarimit;





2. Të ardhura nga pronat që sipas këtij ligji merren parasysh gjatë përcaktimit të të ardhurave të kërkuesit të ndihmës juridike apo të anëtarëve të familjes së vet;
3. Mjet i regjistruar motorik të cilin kërkuesi e përdor për transport të anëtarit të familjes, me invaliditet; dhe
4. Tokë natyrisht jopjellore (krepa, lugina dhe tjera), si dhe livadhe, kullosa, kallamishte dhe moçale të klasës 5, 6, 7 dhe 8, në pajtim me Ligjin për kadastër të patundshmërive.

■ **Aprovim i ndihmës sekondare juridike pa verifikim të gjendjes financiare**

Ndihmë sekondare juridike do të aprovohet pa e verifikuar gjendjen financiare të kërkuesit dhe anëtarëve të familjes së tij nëse:

1. Kërkuesi gjendet në familje akomoduese, njësi banesore për banim të organizuar me përkrahje ose në ent për mbrojtje sociale, me aktvendim të Qendrës për punë sociale;
2. Kërkuesi ka nevojë për inicim dhe përfaqësim në procedurë për shqiptim të masave të përkohshme për mbrojtje nga dhuna në familje pranë gjykatës kompetente; ose
3. Kërkuesi për shkak të katastrofës elementare, forcës madhore ose rrethana të tjera që janë jashtë kontrollit të tij gjendet në situatë financiare që e pengon në mënyrë të pavarur të siguron mbrojtjen e të drejtave të veta.

#### 4. KUSH SIGURON NDIHMË JURIDIKE FALAS?

Ndihmë juridike falas mund të jepet si ndihmë primare juridike dhe ndihmë sekondare juridike.

■ **Ndihmë primare juridike siguron:**

1. person i autorizuar zyrtar nga Ministria e drejtësisë – sektori për ndihmë juridike falas;
2. shoqatë e autorizuar, e regjistruar në Regjistrin e shoqatave<sup>1</sup> pranë Ministrisë së drejtësisë së R. së Maqedonisë së Veriut; dhe
3. klinikë juridike, e regjistruar në Regjistrin e klinikave juridike pranë Ministrisë së drejtësisë së R. së Maqedonisë së Veriut

■ **Ndihmë sekondare juridike siguron:**

1. avokat, i regjistruar në Regjistrin e avokatëve<sup>2</sup> Ministrisë së drejtësisë së R. së Maqedonisë së Veriut.

Mjetet për aprovim të ndihmës juridike dhe shpenzimet për ndihmën e dhënë juridike falas, në procedura janë paraparë me Ligjin për ndihmë juridike, sigurohen nga buxheti i Ministrisë për Drejtësi në Republikën e Maqedonisë së Veriut, si dhe nga donacione dhe të ardhura tjera në pajtim me ligj.


Shoqata mund të regjistrohet (shih Shtojca 14) në Regjistrin e shoqatave të autorizuar për dhënie të ndihmës primare juridike që e mban Ministria nëse i plotëson këto kushte:

1. Të jetë e regjistruar në Regjistrin e shoqatave në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut së paku pesë (5) vite para parashtrimit të kërkesës;

1 Regjistër i shoqatave të cilat ofrojnë ndihmë primare juridike, <http://www.pravda.gov.mk/bpp>

2 Regjistër i avokatëve të cilët ofrojnë ndihmë sekondare juridike, <http://www.pravda.gov.mk/bp-ad-vokati>





2. Të kenë punësuar apo të kenë angazhuar jurist të diplomuar me provim të dhënë për jurisprudencë;
3. Në statutin e shoqatës si një nga qëllimet e themelimit të jetë theksuar dhënia e ndihmës primare juridike në fushën për të cilën është themeluar;
4. Të ketë nënshkruar marrëveshje për sigurim të përgjegjësishëm për dëm të mundshëm gjatë dhënies së ndihmës primare juridike në shumë minimale prej 100.000,00 denarë të policës për sigurim;
5. Të ketë parashtruar fletëparaqitje tatimore vjetore për tre vite para vitit të parashtrimit të kërkesës për regjistrim;
6. Të plotëson kushte minimale hapësinore dhe teknike të cilat garantojnë sigurim të papenguar të ndihmës primare juridike; dhe
7. Të ketë realizuar së paku tre projekte për sigurim të ndihmës juridike ose këshilla juridike.

Shoqata e cila është e interesuar për të dhënë ndihmë primare juridike parashtron kërkesë për regjistrim në Regjistrin e Ministrisë së drejtësisë, bashkë me provat për plotësim të kushteve të përmendura. Formën dhe përmbajtjen e kërkesës për regjistrim në Regjistër i përcakton ministri.

Klinika juridike mund të regjistrohet (shih Shtojca 15) në Regjistrin e fakulteteve juridike për dhënie të ndihmës primare juridike, të cilin e mban Ministria e drejtësisë, pas kërkesës së parashtruar për regjistrim, nëse:

1. Paraqet njësi organizative në fakultet juridik pranë universitetit të themeluar në pajtim me ligj;
2. Është në përbërje të universitetit i cili është i ranguar ndër shtatë universitetet e para në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

#### ■ **Ndihmë sekondare juridike mund sigurojnë vetëm avokatët.**

Që një avokat, i cili jep ndihmës juridike falas, të regjistrohet (shih Shtojca 9) në Regjistrin e avokatëve në Ministrinë për Drejtësi, të RMV-së duhet të parashtrorë kërkesë për regjistrim në Regjistrin e avokatëve, duhet në mënyrë aktive ta ushtron veprimtarinë e avokatit dhe të jetë i interesuar për të dhënë ndihmë sekondare juridike. Pas pranimit të kërkesës së parashtruar, Ministria e drejtësisë e RMV-së, bën kontrollimin e të dhënave nga e njëjta në bashkëpunim me Odën e avokatëve dhe miraton vendim për regjistrim të avokatit në Regjistrin e avokatëve.

#### **4.1 Lloje të ndihmës juridike falas**

Ndihmë juridike falas mund të jepet si ndihmë primare juridike dhe ndihmë sekondare juridike.

**Ndihma primare juridike** jepet nga person zyrtar i autorizuar nga Ministria e drejtësisë, shoqatës së autorizuar dhe klinikës juridike.

#### **Ndihma primare juridike përfshin::**

1. Këshillë juridike fillestare për të drejtën e shfrytëzimit të ndihmës juridike falas;
2. Informatë të përgjithshme juridike;
3. Këshillë të përgjithshme juridike;
4. Ndihmë gjatë kompletimit të kërkesës për ndihmë sekondare juridike;



5. Ndhimë gjatë plotësimit të formave, formularë të lëshuar nga ndonjë organ administrativ në procedurë administrative për mbrojtje sociale dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, sigurim pensional, invalidor dhe shëndetësor, mbrojtje të viktimave nga dhuna e bazuar në gjini dhe dhuna në familje, në procedurë për regjistrim në librin e të lindurve, nxjerrje të dokumenteve për identifikim dhe shtetësi;
6. Përpilim të parashtresave në Komisionin për mbrojtje nga diskriminimi dhe në Avokatin e Popullit, kërkesa për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

**Sigurim i ndihmës primare juridike** – Ndhimë primare juridike i jepet çdo personi të interesuar. Takimi i parë në Ministrinë e drejtësisë, në shoqatën e autorizuar, në klinikën juridike është me qëllim që personit të interesuar t'i shpjegohet natyra e problemit ose të udhëzohet nëse problemi është çështje juridike, nëse i njëjti është në kuadër të spektrit të shërbimeve juridike të cilat i japin Ministria e drejtësisë, shoqata dhe klinika juridike si dhe llojet e ndihmës juridike që janë më të përshtatshme për personin. Ministria e drejtësisë, shoqata dhe klinika juridike nuk kanë të drejtë të veprojnë në emër dhe në llogari të personit, gjatë procedurës për ndihmë primare juridike.

**Ndihma primare juridike që jep Ministria e drejtësisë përfshin:**

1. Këshillë fillestare juridike për të drejtën e shfrytëzimit të ndihmës juridike falas;
2. Informatë të përgjithshme juridike;
3. Këshillë të përgjithshme juridike;
4. Ndhimë gjatë kompletimit të kërkesës për ndihmë sekondare juridike.


Ndhimë primare juridike jep klinika juridike në pajtim me programin për edukim, i miratuar nga ana e fakultetit juridike, ndërsa me qëllim të realizimit të mësimi praktik të studentëve të fakultetit juridik. Gjatë dhënies së ndihmës primare juridike, klinika juridike bashkëpunon me avokatë të regjistruar në Regjistër të avokatëve, si dhe me Odën e avokatëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Ministri i drejtësisë e përcakton mënyrën e bashkëpunimit pas mendimit paraprakisht të pranuar nga Ministria për arsim dhe shkencë dhe Oda e avokatëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

**Ndhimë sekondare juridike** aprovet për person kërkesa e të cilit është e arsyetuar, i cili ka nevojë për ndihmë juridike profesionale nga avokat, për punë konkrete juridike, ndërsa nuk ka mundësi t'i mbulon shpenzimet e procedurës për shkak të gjendjes së vet financiare.

Ndihma sekondare juridike përfshin përfaqësim në procedurë pranë gjyqit, organit shtetëror, Fondit për sigurim pensional dhe invalidor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Fondit për sigurim shëndetësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe persona të cilët ushtrojnë autorizime publike, si dhe lirim nga shpenzimet në pajtim me dispozitat e parapara me këtë ligj dhe ligj tjetër.

Në procedurën për ndihmë sekondare juridike, Ministria e drejtësisë bashkëpunon me Odën e avokatëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut, organet jurisprudente, qendrën për punë sociale, organet shtetërore dhe institucionet tjera kompetente të cilat në pajtim me ligjin kanë për detyrë pa kompensim t'i dorëzojnë të dhënat e duhura në Ministrinë e drejtësisë, për sigurim të ndihmës sekondare juridike, me ç'rast të dhënat dërgohen në pajtim me dispozitat për mbrojtjen e të dhënave personale. Personi i autorizuar zyrtar për çdo kërkesë të parashtruar veçmas për ndihmë sekondare juridike miraton vërtetim me të cilin kërkesa miratohet ose miraton akt si informatë publike me të cilin kërkesi njoftohet që kërkesa refuzohet.





### **Me vërtetimin me të cilin aprovohet ndihmë sekondare juridike:**

1. autorizohet avokati i përcaktuar për dhënie të ndihmës sekondare juridike ;
2. shfrytëzuesi lirohet nga taksat gjyqësore dhe shpenzimet lidhur me procedurën para gjykatës në pajtim me ligjin;
3. shfrytëzuesi lirohet nga shpenzimet për ekspertizë; dhe
4. shfrytëzuesi lirohet nga taksat administrative.

Ekspertiza sigurohet nëpërmjet Byrosë për ekspertizë gjyqësore në pajtim me Ligjin për ekspertizë. Shpenzimet për sigurim të ndihmës sekondare juridike në pajtim me procedurat e parapara me këtë ligj sigurohen nga mjetet e buxhetit të Ministrisë e drejtësisë të RMV-së. Nëse shfrytëzuesi i ndihmës sekondare juridike fiton në kontestin dhe gjyqi e obligon palën tjetër t'ia kompensojë shpenzimet e procedurës në tërësi ose pjesërisht në pajtim me dispozitat e ligjit të cilat e rregullojnë procedurën gjyqësore, në atë rast gjyqi gjatë shqiptimit të vendimit gjyqësor do ta obligon palën tjetër që pagesën e shumës për shpenzime të procedurës ta bëjë në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Kreditor për arkëtim të shpenzimeve në procedurën për përmbarrim në pajtim me Ligjin për përmbarrim është Republika e Maqedonisë së Veriut.

Ndihma juridike falas nuk i përfshin shpenzimet të cilat shfrytëzuesi i ndihmës juridike falas është i detyruar t'i kompensojë nëse humb në procedurën kontestimore. Ndihma sekondare juridike i përfshin të gjitha ato shpenzime të procedurës që janë shfaqur pas ditës së aprovimit të kërkesës për dhënie të ndihmës juridike falas.

#### **■ Spektër i ndihmës sekondare juridike**

Ndihma sekondare juridike aprovohet për përfaqësim në të gjitha nivelet e procedurave civile gjyqësore, të procedurave administrative dhe kontestet administrative. Ndihmë sekondare juridike aprovohet për përfaqësim në procedura për trashëgimi pranë noterit nëse e njëjta ka të bëjë me pronë nga neni. Kjo donë të thotë nëse kërkuesi jeton dhe posedon një objekt njëdhomësh ose një banesë, si pjesë e posaçme e ndërtesës në të cilën jeton si dhe kur bëhet fjalë për pronë e cila ka qenë në pronësi të personit i cili e ka lënë trashëgiminë që nuk është më e madhe se 300 metra katrorë në qytetin e Shkupit ose 500 metra katrorë në komunat tjera të shtetit, ose posedon parcela prej 5000 metra katror që gjenden në mjedise rurale.

Ndihmë sekondare juridike aprovohet për parashtrim të parashtrësive të debitorit pranë përmbarruesit kompetent, kur përmbarrimi zbatohet me shitje të patundshmërisë nga neni 19. Kjo donë të thotë që do të miratohet ndihmë sekondare juridike dhe do të sigurohet avokat i cili do ta përfaqëson personin në procedurën pranë përmbarruesit, nëse bëhet fjalë për shitje të pronës së vetme në të cilën jeton. E njëjta vlen edhe nëse kërkuesi jeton dhe posedon vetëm një objekt njëdhomësh ose një banesë, si pjesë e posaçme e ndërtesës në të cilën jeton, si dhe kur bëhet fjalë për pronë e cila ka qenë në pronësi të paraardhësit të trashëgimtarit e cila nuk është mbi 300 metra katrorë në qytetin e Shkupit ose 500 metra katrorë në komunat tjera të shtetit, ose posedon parcela prej 5000 metra katrorë të cilat gjenden në mjedise rurale.

Procedura për ndihmë sekondare juridike fillon me parashtrim të kërkesës (shih Shtojca 6) për ndihmë sekondare juridike nga personi i interesuar në seksionin rajonal të Ministrisë së drejtësisë që gjendet në zonën ku personi ka vendbanim ose vendqëndrim. Kërkesa parashtrohet personalisht, nëpërmjet postës ose nëpërmjet shoqatës së autorizuar. Personi plotëson dhe parashtron kërkesë të veçantë për ndihmë sekondare juridike për çdo çështje juridike veçmas për zgjidhjen e të cilave inician procedurë.



Personi është i obliguar të japë të dhëna të sakta për çështjen juridike për të cilën kërkohet ndihmë sekondare juridike, për gjendjen financiare të tij dhe gjendjen financiare të anëtarëve të familjes me të cilët jeton si dhe të parashtrojë dy kopje të dokumenteve që i konfirmojnë të dhënat e paraqitura në kërkesën për ndihmë juridike falas, si dhe kopje të dokumenteve të cilat Ministria e drejtësisë nuk mund t'i sigurojë me detyrë zyrtare, ndërsa kanë të bëjnë me çështjen juridike në pajtim me ligjin. Personat kanë të drejtë të parashtrojnë kërkesë për ndihmë sekondare juridike në secilën fazë të procedurës për të cilën kanë nevojë për ndihmë sekondare juridike. Procedura për kërkesën për ndihmë sekondare juridike është urgjente.

## 5. PROCEDURA PAS KËRKESËS PËR NDIHMË PRIMARE DHE SEKONDARE JURIDIKE

### 5.1 Procedura pas kërkesës për ndihmë primare juridike

Dhënësit e kanë për obligim të japin ndihmë primare juridike dhe të bashkëpunojnë ndërmjet vete. Gjatë dhënies së ndihmës primare juridike, dhënësi e njofton personin e interesuar për të drejtat dhe obligimet e shfrytëzuesve të ndihmës juridike falas dhe për procedurën për shfrytëzim të ndihmës primare dhe sekondare juridike, pa kompensim. Dhënësi ka për obligim t'i ndihmon personit ta plotësojë kërkesën për ndihmë sekondare juridike si dhe deklaratën për gjendjen e tij financiare të anëtarëve të familjes vet, me të cilën parashtrohen ato dokumente të cilat vetëm personi i posedon dhe mund t'i sigurojë, ndërsa kanë të bëjnë me çështjen juridike për zgjidhjen e të cilës kërkohet ndihmë juridike. Ministria e drejtësisë me detyrë zyrtare i siguron edhe të gjitha dokumentet tjera të nevojshme nga institucionet kompetente.

Në bazë të takimit të parë me kërkuesin dhe dokumentacionin e përgjithshëm të siguruar, dhënësi më së voni në afat prej dy ditësh nga takimi do të përpilon mendim të shkurtë me shkrim për lëndën të cilën do ta bashkëngjijtë me shkresat dhe do ta kompletton kërkesën për ndihmën sekondare juridike .

